

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), duke vepruar mbi njoftimin për përqendrim të parashtruar nga Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rr. Slavejko Arsov nr.138-1, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut përfaqësuar nga Menka Makarovska, avokate nga Shkupi dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup, me seli të regjistruar në rr. Skupi nr.3A Shkup, përfaqësuar nga Gordana Gatseva, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Trpeski dhe Gaceva Shkup, në seancën e mbajtur më 17.04.2025, miratoi

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rr. Slavejko Arsov nr.138-1, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup me seli të regjistruar në rr. Skupi nr.3A Shkup fitojnë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup me seli të regjistruar në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes blerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengesë, kufizim apo shtrembërim të rëndësishëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, sidomos si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë tarifë administrative për njoftim për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 denarë dhe për vendimin në vlerë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e prolongon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 10.03.2025, dhe e plotësuar më 17.03.2025 te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rr. Slavejko Arsov nr.138-1, Shkup, dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup me seli të regjistruar në rr. Skupi nr.3A Shkup, me të cilin Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA

GRADBA SHPK Shkup me seli të regjistruar në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit me ditën e marrjes së tij dhe në bazë të të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, plotësimeve dhe aneksimeve ndaj tij konstatoi sa vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

-Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup është e regjistruar për aktivitet të tregtisë me pakicë të karburanteve dhe lubrifikantëve në dyqane të specializuara. Shoqëria ka një person të lidhur (mbi të cilin ka 100% pronësi):

-Shoqëria për tregti dhe shërbime OMPETROL OIL SHPKNJP Petrovec me seli në rr.4 nr.100, Rzhaniçino Petrovec, Republika e Maqedonisë së Veriut e cila është e regjistruar për aktivitet të tregtisë me shumicë të karburanteve të ngurta, të lëngshme dhe të gazta dhe produkteve të ngjashme, gjegjësisht bën tregti me shumicë të naftës dhe derivateve të saj në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me licencën e Komisionit Rregullator për Energjetikë.

-Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup është me aktivitet të regjistruar – aktivitete menaxheriale. Shoqëria është pronare/bashkëpronare mbi këto persona juridikë:

- 100% pronësi mbi Shoqërinë tregtare ndërtimore BETON SHTIP SHPKNJP Shtip, me seli në rr. Goce Dellçev nr. 117 Shtip, me aktivitet të regjistruar: ndërtim i objekteve banesore dhe jo banesore;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime DELTA 2015 CONSTRUCTION SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: ndërtim i objekteve banesore dhe jo banesore;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime KARA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: dhënie me qira dhe menaxhim të pasurisë së paluajtshme në pronësi apo me qira (lizing);
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime MONT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: prodhim i veshjeve të sipërme të tjera;
- 100% pronësi e IPSH – Qendra e Dializës NEFROPLUS Kavadar, me seli në rrugën Shishka nr. 1, Kavadar, me aktivitet të regjistruar: aktivitete të praktikës mjekësore specialistike;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime O.K. HOTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: hotele dhe objekte të ngjashme për akomodim;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për reklamë, marketing, tregti dhe shërbime O.K. IDEA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: agjenci për marketing;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për tregti dhe shërbime OK MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: reklamim nëpërmjet mediave;

- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hoteleri, tregti dhe shërbime O RESTAURANTS & BARS SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Aminta i Tretë nr. 29 Shkup, me aktivitet të regjistruar: restorante dhe objekte të tjera për gatim dhe shërbim ushqimi;
- 100% pronësi mbi Agjencinë për siguri të pasurisë dhe të personave OK SECURITY SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: veprimtari të mbrojtjes private;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për transport, tregti dhe shërbime OK TRANSPORT SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: transport rrugor mallrash;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hoteleri dhe turizëm ORKA HOTEL SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Orce Nikolov nr. 55 Shkup, me aktivitet të regjistruar: hotele dhe objekte të ngjashme për akomodim;
- 100% pronësi mbi Shoqërinë për hoteleri dhe shërbime PANORAMA REZIDENS SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: ndërtim i objekteve banesore dhe jo banesore;
- 100% pronësi mbi Fondacionin Ilija Kamçev Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 3A Shkup, me aktivitet të regjistruar: veprimtari të organizatave të tjera në bazë të anëtarësimit, të pa përmendura tjetërkund;
- 47% pronësi mbi IPSH në pronësi të përbashkët Klinika spitalore ACIBADEM SISTINA Shkup, me seli në rr. Skupi nr. 5A Shkup, me aktivitet të regjistruar: veprimtari të spitaleve.

-Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup, me seli në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, është e regjistruar për ndërtimin e objekteve banesore dhe jo banesore. Kjo shoqëri nuk ka realizuar të ardhura në vitin 2022, si vit që i paraprin përqendrimit.

Shoqëria për ndërtimtari, tregti dhe shërbime BEST VEJ INVESTMENT SHPKNJP Shkup dhe Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime ORKA HOLDING SHA Shkup zotërojnë nga 50% të pjesëve në Shoqërinë për ndërtimtari, tregti dhe shërbime SOFIJA GRADBA SHPK Shkup me seli në rr. Orce Nikolov nr. 71/1 Shkup, dhe kështu kanë kontroll të përbashkët mbi të.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ